



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.101/22.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtarin ligjor Albert Haliti në kontestin tregtar administrativ të paditësit N.T “N...C...”, me seli në Ferizaj, Rr.” ...”, të cilin e përfaqëson menaxheri N.M., kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlera e kontestit e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 20.03.2023, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditësit, N.M. - menaxher, përfaqësuesit të autorizuar të paditurit B.S., si dhe në prezencë të B.M., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.T “N...C...”, me seli në Ferizaj, Rr.” ...”, të cilin e përfaqëson menaxheri N.M., si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 06.2/192 dhe 01.3.2.2/313/2017 i datës 20.10.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 01.12.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.06.2/192 dhe 01.3.2.2/313/2017 të datës 20.10.2020, për shkak të provave të njëjta nga ana e Doganës dhe mungesës së fakteve të reja, me arsyetim se e paditura në pamundësi të argumenteve dhe fakteve nuk ka arritur të qartësoj asnjë fakt,

por ka theksuar se importuesi në kontratë ka mangësi të elementeve, gjë që nuk është e saktë, pasi që ne çdo herë kur importojmë mall të gjitha dokumentet i kemi të harmonizuara sipas ligjit, dhe i paraqesim pranë organeve doganore për zhdoganim dhe gjatë seancave gjyqësore. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Bëjmë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që kërkojmë nga gjykata që: të aprovohet padia si e bazuar, të anulohet pjesërisht vendimi kontestues nr.06.2/192 dhe 01.3.2.2/313/2017 i dt:20.10.2020, dhe atë vetëm në pikën 1 dhe 2 të këtij aktvendimi dhe të obligohet e paditura që mjetet e paguara më tepër për DUD-at R-3543 dhe R-3545 t'ia kthej paditësit. Sa i përket çmimeve të deklaruara, të njëjta janë reale sepse çmimi ndryshon varësisht nga kualiteti i mallit dhe qëndrojmë pranë padisë dhe atyre që u thanë në këtë seancë. Si prova për të vërtetuar çmimin e mallit të cilat i janë bashkëngjitur DUD-it janë faturat dhe urdhërpagesat bankare të mallit. I propozojmë gjykatës që të veproj sipas precizimit të padisë të bërë në këtë seancë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 07.12.2021 e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike, andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa-bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi aktvendimin e të paditurës në pjesën refuzuese të dispozitivit. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë të cekurave nga seancat e kaluara. E kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar pasi që konsiderojmë se e paditura bazuar edhe në vërejtjen e dhëna nga gjykata kur lëndën ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje ka trajtuar të njëjtat me ç 'rast ka aprovuar kërkesën për DUD-at: R-3549/28.02.2017 dhe R-10623/27.04.2017, meqenëse paditësi për këta dy DUD-a ka argumentuar vlerën e transaksionit, kurse sa i përket DUD-ave R-3543/28.02.2017 dhe R-3545/28.02.2017 ka

refuzuar kërkesën si të pabazuar meqenëse paditësi nuk ka arritur të argumentojë para doganës se vlera e prezantuar para doganës paraqet vlerën reale të paguar, gjithnjë duke pasur parasysh se për DUD-in R-3543, dogana disponon me të dhëna që malli i ngjashëm është importuar nga i njëjti shtet eksportues në Kosovë me vlerë me të lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, këtu paditësi, ku për këtë janë paraqitur edhe si provë DUD-at e përshkruar në aktvendimin kontestues, ndërsa sa i përket DUD-it R-3545, janë gjetur të dhëna të disponueshme bazuar në nenin 35 të KDAK-së se vlera është më e lartë se ajo e deklaruar. Rrjedhimisht, kërkesa për këta dy DUD-a është refuzuar si e pabazuar. Mbi bazën e provave dhe argumenteve të paraqitura në këtë seancë dhe seancat e kaluara, konsiderojmë se mjaftueshëm është argumentuar se e paditura ka vepruar drejtë kur ka rivlerësuar mallin lëndor kontestues dhe ka ofruar prova mbi rivlerësimin e bërë, andaj mbi bazën e këtyre fakteve i propozojmë gjykatës që të sjell aktgjykim me të cilin refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe lë në fuqi vendimin kontestues. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 20.03.2023 ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi nr.06.2/192 dhe 01.3.2.2/313/2017 i dt:20.10.2020, Aktvendimi nr.192 dhe 313 i dt:26.05.2017, Aktvendimi nr.120/2010 – DK i dt:04.03.2013, Aktvendimi nr.18/2010 – DK i dt:04.03.2013, Aktvendim nr.234-235,1537 i dt:24.04.2012, DUD-at: R-9782/29.09.2014, R-8373/10.04.2018, R-7538/25.06.2015, R-8827/08.09.2014, R-810/02.02.2015, R-14435/01.06.2017, R-3549/28.02.2017, R-29241/26.10.2018, R-3543/28.02.2017, R-3545/28.02.2017, R-5514/10.03.2016, R-2933/03.04.2015, R-800/23.01.2017, Kuponët fiskal, Një fotografi e mallit; Përgjigja në padi e dt:07.12.2021, e-maillet e dt:30.07.2020, 29.07.2020, Urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të dt:14.02.2017, 28.02.2017, Faturat nr.590530, nr.R00018, nr.IZ00013, nr.248641, nr.113070, nr.112926, nr.030102, nr.0-16016-TWEB, Deklaratat EX3 dhe EX1, Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Informatat mbi biznesin, Kundërshtimi i ushtruar në Doganën e Kosovës nr.192/27.03.2017, Deklarata DV1, Pro-fatura pa numër e dt:13.02.2017, CMR; Packing List, si dhe EUR1.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti N.T “N...C...”, me seli në Ferizaj, ka paraqitur DUD-at R-3543/28.02.2017, R-3545/28.02.2017, R-3549/28.02.2017 dhe R-16023/27.04.2017, proceduar ZD Hani i Elezit, për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura me datë 26.05.2017, ka sjell aktvendimin nr.06.2/192, 01.3.2.2/313, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtij paditësi, e ku lidhur me këtë lëndë Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Fiskal, duke vendosur sipas padisë së paditësit me Aktgjykimin A.nr.1106/17 të datës 06.07.2020, ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin nr.06.2/192, 01.3.2.2/313, duke e kthyer lëndën në rivendosje tek e paditura, ndërsa e paditura duke vepruar sipas këtij aktgjykimi në rishqyrtim dhe rivendosje me datën 20.10.2020 ka sjell aktvendimin nr.06.2/192 dhe 01.3.2.2/313/2017, me të cilin prapë ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e DUD-ave R-3543/28.02.2017 dhe R-3545/28.02.2017, ndërsa ka aprovuar kërkesën e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e DUD-ave R-3549/28.02.2017 dhe R-16023/27.04.2017, duke lejuar kthimin e mjeteve të paguara më tepër subjektit në procedurë në emër të

biznesit D.M. B.I, dhe me emër tregtar N.T “N...C...”, e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 01.12.2020 ka iniciuar prapë këtë kontest tregtar administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë N.T “N...C...”, me seli në Ferizaj, këtu paditësit, për rishqyrtimin e DUD-ave R-3543/28.02.2017 dhe R-3545/28.02.2017, të proceduar në ZBD Hani i Elezit. Me arsyetim se paditura Dogana e Kosovës fillimisht ka konstatuar se Sektri i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur për Deklaratat Unike Doganore R-3543/28.02.2017 dhe R-3545/28.02.2017, ka kontestuar vlerën e mallin lëndor pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështirë të nenit 33 të KDA-së, dhe ka aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit neni 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme. Po ashtu, e paditura Dogana e Kosovës ka konstatuar se Zyra Doganore gjatë vlerësimit të mallit kontestues për DUD-in R-3543/28.02.2017 ka vepruar drejtë kur bazë për rivlerësim ka marrë DUD-in R-800/23.01.2017 të ZBD Ferizaj, ku ka konstatuar se DUD-i që është marrë për bazë është zhdoganuar në periudhë të afërt kohore me mallin kontestues me kod tarifor të njëjtë, përshkrim të ngjashëm, shtet të origjinës së njëjtë, por që ka vlerë më të lartë të transaksionit se sa vlera e deklaruar e subjektit ankimor, andaj, Dogana ka konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka aplikuar nenin 34 par.2 pika b) të KDA-së, sipas vlerës së transaksionit të mallrave të ngjashme. E paditura Dogana e Kosovës gjatë analizimit të çështjes kontestuese ka hulumtuar në sistemin COGNOS dhe ASYCUDA importet e subjektit në procedurë dhe subjekteve tjera të cilët kanë importuar mallin e ngjashëm, dhe ka konstatuar se kemi importe tjera të importuesve të ndryshëm që kanë importuar mallin e ngjashëm me mallin lëndor kontestues në periudhë të afërt kohore që kanë të bëjnë me karakteristika të njëjta, por që kanë vlerë më të lartë të transaksionit. Gjithashtu, e paditura Dogana e Kosovës ka konstatuar se Zyra Doganore gjatë vlerësimit të mallit kontestues për DUD-in 3545/28.02.2017, ka vepruar drejtë kur bazë për rivlerësim ka marrë DUD-in R-5514/10.03.2016, ku ka konstatuar se DUD-i që

është marrë për bazë është me kod tarifar të njëjtë, përshkrim të ngjashëm, shtet të origjinës së njëjtë, importues të njëjtë, por që ka vlerë më të lartë të transaksionit se sa vlera e deklaruar e subjektit ankimor, andaj, Dogana e Kosovës këtë Import e ka marrë si të dhënë të disponueshme, përkatësisht nenit 35 të KDA-së. Prandaj, nga kjo gjendje faktike, gjykata e ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44, paragrafi 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas paragrafi 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit se çmimet e deklaruar janë reale, dhe se çmimi ndryshon varësisht nga kualiteti i mallit, i cili pretendim është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës, ngase në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e deklaruar, kjo pasi që nuk ka prezantuar dokumentacion të harmonizuar në mes të transfereve bankare, pro-faturave dhe faturave të mallit lëndor kontestues, si dhe dokumentacionin tjetër mbështetës për ta provuar vlerën e transaksionit si të pakontestueshme, andaj gjykata e pranon si të drejtë konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, këtu e paditura. Gjykata ka gjetur se transaksioni bankar ndërkombëtar i datës 14.02.2017 në përshkrim të pagesës i referohet profaturës së datës 13.02.2017, dhe e cila pro-faturë nuk është bashkangjitur DUD-it kontestues 3543/28.02.2017, dhe as në procedurë të ankimimit pranë të paditurës dhe as gjykatës deri në përfundimin e këtij shqyrtimi gjyqësor, andaj edhe gjykata e ka pasur të pa mundur ta bëjë lidhjen ndërmjet transaksionit bankar ndërkombëtar si më lartë

me faturën nr. 248641, tutje Gjykata ka gjetur se transaksioni bankar ndërkombëtar tjetër i datës 14.02.2017 në përshkrim të pagesës i referohet faturës nr. 2017 0011 të datës 14.02.2017, faturë kjo që nuk korrespondon me faturën nr. 113070/23.02.2017 të DUD-it kontestues 3545/28.02.2017, andaj edhe gjykata nuk ka mundur të bëj vlerësim ndryshe nga ajo që është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Pastaj e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm në aktvendimin kontestues edhe kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën, duke filluar nga metoda e parë dhe në mënyrë kronologjike deri në metodën e gjashtë. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor me të dhëna dhe referenca të sakta në urdhërpagesat ndërkombëtare. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provën materiale si faturat e mallit, e njëjta nuk ka arrit të dëshmoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër e cila është në harmoni të plotë me shumën dhe përshkrimin e faturës për mallin e importuar.

Nga ana tjetër e paditura posedon informacione nga Dosja e Vlerës dhe zhdoganimet të mallrave të ngjashme, ku si fakte vendimtare që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor ka qenë se e paditura Dogana e Kosovës është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit, neni 35 i Kodit Doganor dhe Akcizave respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor, janë provë e bazuar për tu rivlerësuar malli lëndor sipas nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjithmonë deri sa nuk dëshmohet ndryshe me dokumentacion përcjellës nga paditësi.

Në vijim pretendimin e paditësit se e paditura Dogana e Kosovës në aktvendimin e kontestuar në pamundësi të argumenteve nuk ka arritur të qartësojë asnjë fakt, por ka

theksuar se importuesi në kontratë ka mangësi të elementeve gjë që nuk është e saktë, gjykata e ka vlerësuar si të pa bazuar, ngase përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmojë provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se çdo herë kur importojmë të gjitha dokumentet i kemi të harmonizuara sipas ligjit, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë kontest tregtar - administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtetë paditësi ka paraqitur vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar*



ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”. Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsytim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, parag. 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.101/22 datë 20.03.2023

Zyrtari Ligjor

Albert HALITI

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.